




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Këshilli i Ministrave



V E N D I M

Nr. 541 , datë 31.10.2002

P Ë R

MIRATIMIN E STUDIMIT TË FIZIBILITETIT TË SHËRBIMIT TË TRAFIKUT AJROR SHQIPTAR, PËRGATITUR NGA SHOQËRIA NDËRKOMBËTARE " LOCKHEED MARTIN"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 7, të ligjit nr.7877, datë 30.11.1994, "Për aviacionin civil", me propozimin e ministrit të Transportit dhe të Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Miratimin e studimit të fizibilitetit të shërbimit të trafikut ajror shqiptar, i cili i bashkëlidhet këtij vendimi, të përgatitur nga shoqëria ndërkombëtare "Lockheed Martin".

2. Autorizohet Ministria e Transportit dhe e Telekomunikacionit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Aviacionit Civil të negociojnë me shoqërinë ndërkombëtare "Lockheed Martin", zbatuese e këtij studimi, dhe të përgatisin e të paraqesin për miratim në Këshillin e Ministrave aktet e nevojshme, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E M I N I S T R I

FATOS NANO

MINISTRI I TRANSPORTIT
DHE I TELEKOMUNIKACIONIT
SPARTAK POÇI